REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 883/20
Datë/Datum. 06.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Shefkinaze Vllasaliu	**05.11.2020**	**05.11.2020**	**883-20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.11.2020, Tenderuesi : "COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, "Lidhja e Prizerenit" p.n Klinë, ka parashtruar ankesë me nr: 883/20, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (16.10.2020) - njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë, Grup i Operatorëve Ekonomik **"Matrix Construction"** Sh.p.k **& "Trasing Group"** sh.p.k., **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "RREGULLIMI I URAVE NE POTERQ DHE UJMIR" me nr. të prokurimit: 634-20-5795-5-3-6, dhe numër të brendshëm : 634-20-095-536, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDIN KOMUNAL KLINË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **9,500.00 €,**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Tenderuesi ankues, "COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, "Lidhja e Prizerenit" p.n Klinë, pretendon se AK, ka bërë shkelje te dispozitave të *Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (më tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë konkretisht*:

Neni 1, *Qëllimi*

Neni 6 - *Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*

Neni 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 59, *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

Neni 60, *Kriteret pre Dhënien e Kontratës*
RRUOPP

8. Deklarartë detale mbi faktet dhe argumentet

Letrën standarde për tenderues te pa sukseshem e kemi pranuar permes platforems elektronike , me pas me daten 16.10.2020 kemi parashtura Kerkes per Qasje ne Dokumetnacion

Gjatë qasjes ne dokumentacion ne kemi vrejtur nje numer te madh te shkeljeve qe jane bere ne momentin e shpalljes fitues te Kompanisë Matrix Construction shpk & Trasing Group shpk nga ana e Autoritetit Kontraktues .

Autoriteti Kontraktues gjatë vlersimit ka eliminuar kompanin Nit Construction sh.p.k. me oferte finaciare me cmimi me te lire , me arysetim se ky operator ekonomike është i papergjegjshem ne aspektin administrative por gjatë qasje ne kemi vrejtur qe kompanin Nit Construction sh.p.k. ka kontrate pune me afat të pacaktura me pronarin e Matrix Construction shpk Shkelzen Shalen me nr. të id 1242486958 , Autoriteti Kontraktues e ka eleminuar oferten e Nit Construction shpk ne vlere 6.403,70 euro ndersa e ka shpallur fitues Matrix Construction shpk ne vleren fianciare 7.157,00 euro , duke bërë shkelje te LPP-së , ku i njëjtin person në njëra anë figron si i punësuar ndersa ne anën tjetër si pronar , duke ofertuar ne procedure e njëjtë të prokurimit.

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk ka prezentuar afatin kohore(planin dinamik) per perfundimin e punimve siq kerkohe ne **II.6** **Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës:** në muaj ose në ditë **10**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk ka prezentuar Deklarate mbi Specifikmet Teknike por as Specifikimet Tekniks siq i parasheh **II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike** - *punët* ☒ *furnizimet* ☐ *shërbimet* ☐ duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.
Duke mos ofruar Deklaraten mbi Aneksin 1 te dosjes se Tenderit , por as Specifikmet Teknike

Lidhur me pretendimin ne Vendimin mbi Kerkesn per Rishqyrtim ,qe citon se pretednimet i kemi dhene per nje Operatore Tjeter pa pasur Autorizim ne i themi qe ju kemi njoftuar me Kerkes per rishqyrtim qe keni bere shkleje te LPP kur keni shpallur fitues kompanin Matrix Construction shpk & Trasing Group shpk nga që shihet ne dokumentacionin e dorzuar qe keto dy kompani kanë nderlidhje nder vete dhe kan ofertuar me dy cmime dhe pastaj jane shperblyer me kontrate me cmimi me te favorshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Tenderuesi ankues, "COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, "Lidhja e Prizerenit" p.n Klinë, *është palë me interes sipas nenit 4.1.26* nga rezultati i këtij aktivitetit të prokurimit të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDIN KOMUNAL KLINË, në raport me këtë kontratë që mund të jetë në rrezik të dëmtimit material nga një shkelje e pretenduar.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasë.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Tenderuesi Ankues, "COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, Klinë, deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KUVENDIN KOMUNAL KLINË të datë 16.10.2020 dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjate vlerësimit të tenderit.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

Neni 1, *Qëllimi*

Neni 6 - *Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*

Neni 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 59, *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

Neni 60, *Kriteret pre Dhënien e Kontratës*

RRUOPP

Kerkojme nga OSHP duke u bazuar në gjetjet dhe faktet e ofruar ta bëjë një vlersim të drejtë dhe korrekt , duke u mbeshtetur ne LPP , ta ANULOJË vendimi per shperblim me kontrate dhe ta kthej lenden ne ri-vlersim .

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

NENI II QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës: **RREGULLIMI I URAVE N POTERQ DHE UJMIR**

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike - *punët* ☒ *furnizimet* ☐ *shërbimet* ☐ duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.

II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: në muaj ose në ditë **10** ose
fillim përfundim

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni nuk ka dhënë vërejtje përmbyllëse.

DEKLARATË

OE te eliminuar
Ndertimi shpk nga Peja nuk ka validitet të ofertës
O.E. KBC – nga Prishtina nuk ka prezantuar fuqine e angazhuar të punëtorëve
O.E. Nit Vonstruction nga Klina nuk ka referenca për natyrë të njejtë dhe NNP EU nuk ka prezantuar referenca per pune te ngjashme

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar **sqaron me sa vijon:**

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 1)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (*Qëllimi*) është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues, me të drejtë e ka shpallur fitues, Grup i OE "**Matrix Construction**" Sh.p.k & "**Trasing Group**" sh.p.k., Klinë, i cili ka *ka dorëzuar tenderin* e përgjegjshëm me çmim më të ulët, prej **7,157.00 €**, andaj ky veprim gjatë vlerësimit është në pajtueshmëri me Nenin 1 të LPP-së, citojmë :

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 6)*.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (***Ekonomiciteti dhe Efikasiteti***) është i pabazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues me shpalljen e tenderuesit fitues, tenderuesin Grup i OE "**Matrix Construction**" Sh.p.k & "**Trasing Group**" sh.p.k., Klinë, që është me çmim më të ulët se tenderuesi ankues (COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, Klinë), ka dështmuar se këtë proces e ka udhëhequr në pajtim me parimet bazike Efikasiteti & Efektiviteti, për të siguruar **vlerën për paranë publike,** veprim ky që është në pajtueshmëri me Nenin 6 pika 1. të LPP-së, sepse citojmë :

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 7)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**) është i pabazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm.
Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit Grup i OE "**Matrix Construction**" Sh.p.k & "**Trasing Group**" sh.p.k., Klinë, fitues për këtë kontratë nuk ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së tij, i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i përgjegjshëm, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 7 të LPP-së dhe nuk është bërë kurrfarë diskriminimi i tenderuesit ankues, i cili në mungesë të argumenteve për tenderin e vet, pa të drejtë mundohet ta mbrojë tenderuesit tjetër pjesëmarrës.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 59)*,*Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, <u>është i pabazuar</u>, sepse me kontrollimin dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues <u>e ka bërë</u> Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues e ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin të ofertave në pajtueshmëri me të gjitha Kërkesat e dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit :
III.1 Kërkesat e pranueshmërisë
III.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale;
III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
dhe me të drejtë e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm, Grup i OE "**Matrix Construction**" Sh.p.k & "**Trasing Group**" sh.p.k., Klinë.

- Eksperti shqyrtues në bazë të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender, ka konstatuar se pretendimi i palës ankuese në ankesë, se Tenderuesi i shpallur fitues në tenderin e tij citoj: nuk ka prezantuar afatin kohore (planin dinamik) për përfundimin e punimeve siç kërkohet ne II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: në muaj ose në ditë 10

  <u>nuk qëndron</u>, *sepse me dosje të tenderit Plani dinamik nuk është kërkuar <u>si kërkesë</u> por është kusht i ekzekutimit të kontratës* - për nisje dhe përfundim të kontratës.

- Eksperti shqyrtues në bazë të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender, ka konstatuar se pretendimi i palës ankuese në ankesë, se Tenderuesi i shpallur fitues në tenderin e tij, citoj: nuk ka prezantuar Deklarate mbi Specifikimet Teknike por as Specifikimet Teknike siç i parasheh II.4 **Specifikimet e detyrueshme teknike** - punët furnizimet shërbimet duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikime teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1

  <u>nuk qëndron</u>, sepse me dosje të tenderit nuk është kërkuar <u>si kërkesë</u> por është Informatë për Operatorët Ekonomik pjesëmarrës dhe qëllim i kontratës - **RREGULLIMI I URAVE NË POTERQ DHE UJMIR**, ku tenderuesi i shpallur fitues Grup i OE "**Matrix Construction**" Sh.p.k & "**Trasing Group**" sh.p.k., Klinë, <u>e ka nënshkruar dhe vulosur **Paramasen dhe parallogarinë**, e cila i përmban specifikimet teknike të parashtruara nga Autoriteti Kontraktues, **kurse Aneksi 1**</u>. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, për të cilin thirret tenderuesi ankues, nuk është i plotësuar fare nga AK dhe nuk ka pas nevojë të nënshkruhet.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk ka shkelje të nenit 59 të LPP-së, sepse vlerësimi është bërë në pajtueshmëri ne këtë nen.

<u>Përgjigje në pretendimin e lartë cekur</u> *<u>(Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës)</u>*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues ("COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, Klinë), se <u>nuk është zbatuar si duhet</u> Nenin 60 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (*<u>Kriteret për Dhënien e Kontratës</u>*) <u>nuk është i bazuar</u>, sepse në tërësi është respektuar ky nen ku kërkohet (*citojmë*) :

LPP ne nenin 60 paragrafi 1.dhe nen paragrafin 1.1 përcakton:

1. *Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:*
1.1 tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët:

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne pajtueshmëri me nenin 60, duke e shpallur fitues **tenderuesin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, Grup i OE **"Matrix Construction"** Sh.p.k & **"Trasing Group"** sh.p.k., Klinë.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që të **REFUZOHET** ankesa e Tenderuesit ankues, "COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, Klinë, **e pabazuar,**
njëherësh propozoj, **që të aprovohet** Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "RREGULLIMI I URAVE NE POTERQ DHE UJMIR", i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDIN KOMUNAL KLINË dhe të vazhdojë sipas dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDIN KOMUNAL KLINË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues : - "COYOTE CLEAN GROUP" SHPK, Klinë,